



Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për sportistët më të suksesshëm – nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit nr. 08-8238/1 datë 08.07.2026, dhe në lidhje me Programin për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2026 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25 dhe 3/26), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE
për ndarjen e mjeteve financiare në vitin 2026
për sportistët më të suksesshëm– nxënës të shkollave të mesme
në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit

1. Lënda e Thirrjes publike

1.1. Lëndë e Thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare në vitin 2026 për sportistët më të suksesshëm - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit, me qëllim rritjen e motivimit të sportistëve të rinj - nxënës të shkollave të merren me sport, të vazhdojnë dhe të qëndrojnë edhe më tej në sport, si dhe rritjen e përfshirjes të sa më shumë nxënësve për t'u angazhuar në sport dhe aktivitete sportive.

1.2. Mjetet nga pika 1.1 janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026.

1.3. Ndarja e mjeteve financiare në vitin 2026 për sportistët më të suksesshëm - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit, përcaktohet me kushte dhe kriteret të veçanta, të cilat janë pjesë përbërëse e Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për sportistët më të suksesshëm - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit nr. 08 - 8238/1 data 08.07.2026.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë nxënës të rregullt dhe të çrregullt në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit, të cilët plotësojnë kriteret e Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për sportistët më të suksesshëm - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit dhe që kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kriteret të përgjithshme

3.1. Aplikantët për të drejtën për të marrë mjete financiare, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

- a) të jenë nënshetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- b) të jenë banorë të qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare);
- c) të jenë nxënës të rregullt ose të çrregullt në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit;
- d) të jenë sportistë aktivë dhe anëtarë të klubeve sportive të regjistruar në Regjistrin Qendror me seli në qytetin e Shkupit dhe të jenë përfaqësues të ekipit kombëtar të regjistruar në federatat kombëtare sportive përkatëse;

e) të ketë arritur sukses në arsim (nota mesatare në dëftesë);

f) të kenë arritur rezultate të larta sportive në sportet ekipore dhe individuale nga periudha 27.07.2025 deri në përfundimin e Thirrjes publike të shpallur në vitin në vijim, si më poshtë: medalje të fituara në kampionatet botërore, evropiane dhe ballkanike në sportet olimpike dhe jo olimpike, medalje të fituara në kupat botërore dhe evropiane në sportet olimpike, fitues të kampionatit vendas apo kupave shtetërore, si dhe të kenë arritur rezultate të larta personale individuale në nivel përfaqësues dhe të kenë vendosur rekorde shtetërore në gara zyrtare.

3.2. Aplikimet e pranuar hapen, shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i formuar nga kryetari i Qytetit të Shkupit.

3.3 Aplikimet e depozituara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe kriteret për pikët që janë pjesë përbërëse e Rregullores, që do të shpallet në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

3.4. Në procedurën e ndarjes së mjeteve financiare, do të përzgjidhen ata aplikantë të cilët në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe kriteret për pikët të përcaktuara në Rregullore, do të sigurojnë minimumi 50 pikë.

4. Mënyra e aplikimit dhe dokumentacioni i detyrueshëm

- 4.1. Aplikimi në Thirrjen publike kryhet me depozitimin e aplikimit të plotësuar plotësisht (aplikimi do të shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk)
- 4.2. Aplikantët që marrin pjesë në Thirrjen publike, për përmbushjen e kriterëve detyrimisht duhet të depozitojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) kopje nga certifikata e lindjes e aplikantit;
 - b) vërtetim nga shkolla e mesme ku aplikanti është nxënës i rregullt ose i çrregullt në vitin shkollor në vijim;
 - c) kopje nga dëftesa për vitin shkollor të përfunduar më parë;
 - d) vërtetim nga klubi sportiv se është anëtar i të njëjtit;
 - e) vërtetim nga federata kombëtare amë për rezultatet e arritura sportive nga periudha e cituar në Thirrjen Publike të shpallur në vitin në vijim dhe se është përfaqësues i ekipit kombëtar;
 - f) vërtetim për vendbanim në qytetin e Shkupit (vendbanim në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorge Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare) ;
 - g) kopje e faqes së përparme të llogarisë së transaksionit (vetëm personale e aplikantit, e paautorizuar nga palë e tretë, dhe nëse aplikanti është i mitur, llogaria e transaksionit duhet të jetë vetëm personale e aplikantit e autorizuar nga prindi/kujdestari)
 - gj) dëshmi se janë të regjistruar si tatimpagues në sistemin E-PDD të Drejtorisë për të Ardhura Publike

5. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

- 5.1. Thirrja publike shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).
- 5.2. Thirrja publike do të zgjasë 15 ditë, llogaritur nga dita e shpalljes së saj.
- 5.3. Dokumentacionin e nevojshëm aplikantët e depozitojnë në zarf të mbyllur, pranë Komisionit nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit (baraka 16), me shënimin: "Saktori për Veprimtari Publike - Komisioni për zbatimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për sportistët më të suksesshëm - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupit, banorë të Shkupit".
- 5.4. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë aplikantin.
- 5.5. Aplikimi me dokumentacionin e nevojshëm depozitohet në një kopje origjinale, i plotësuar plotësisht dhe i nënshkruar nga aplikanti për mjetet financiare.

6. Mënyra e zbatimit të Thirrjes publike

- 6.1. Për të përcaktuar përmbushjen e kriterëve nga Rregullorja për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare, kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komisionin për ndarjen e mjeteve financiare për sportistët më të suksesshëm - nxënës të shkollave të mesme në territorin e qytetit të Shkupi, banorë të Shkupit.
- 6.2. Për aplikimet e kompletuara, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kriteret e Rregullores, Komisioni depoziton propozim pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit për ndarjen e mjeteve financiare aplikantëve.
- 6.3. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare.
- 6.4. Komisioni nuk do të shqyrtojë aplikimet e depozituara jashtë afatit të caktuar.
- 6.5. Komisioni do të njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar si të pakompletuara, të depozituara jo në kohë dhe që nuk plotësojnë kriteret e Rregullores.

Për informacione plotësuese:

Informacione plotësuese mund të merren në Sektorin për Veprimtari Publike – Seksioni për sport dhe të rinj në telefonat: 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT